



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 060/01-21432/20
Kaçanik, 08.09.2020

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VII-të (Shtatë)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2020 (Legjislatura e VI-të), mbajtur me 08 Shtator 2020. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve të KK, pjesëmarrës në mbledhje fillimisht ishin 25 anëtarë, ndërkaq gjatë shqyrtimit të pikës së tretë erdhi anëtarja Fatijona Kyçyku, kështu që konstatohet se nga kjo pikë pjesëmarrës në mbledhje janë 26 anëtarë. Në mbledhje mungoj me arsye anëtari, Bekim Koxha.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive komunale; Bahri Selimi, Ramadush Osmani, Ukshin Qallaku dhe Festim Neziraj, ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishin: Bejtulla Dallosi dhe Arbnora Kuka.

Nga OJQ (KDI), mbledhjen e monitoroj, Kijani Sallahu.

Në pjesën e parë të mbledhjes mori pjesë edhe zyrtari i KKZ, Artan Mezraja.

Nga strukturat vendore, mbledhja monitorohet përmes, Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, përshëndeti anëtarin e re të KK nga AAK, Rabije Sallahi, konstatoj kuorumin duke i thirrur emër për emër të gjithë anëtarët e KK. Pjesëmarrës në mbledhje janë për momentin, 25 anëtarë, anëtari Bekim Koxha me ka lajmëruar së nuk mund të merr pjesë në mbledhje për shkak të dyshimit të infektimit me Covid -19, ndërkaq Fatijona nuk me ka lajmëruar, ka mundësi që u vonuar e vjen në ndërkohë. Kuorumi ekziston, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e VII-të (Shtatë) të Rregullt për vitin 2020, data 08 Shtator 2020 , me këtë:

REND PUNE

1. Betimi Solemn i anëtares së zgjedhur të Kuvendit të Komunës nga AAK, Rabije Sallahi;
2. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
3. Raporti i Auditorit për pasqyrat financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin 2019;
4. Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit për PFV 2019;
5. Propozim Vendimi për rialokimin dhe transferin e mjeteve nga rezerva komunale sipas buxhetit të vitit 2020;
6. Propozim Vendim për Rialokimin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2020;

7. Propozim Vendimi për Plotësim Ndryshimin e Vendimit të Kuvendit Komunal 01Nr.104/02-12813/2018 të datës 27.04.2018 për formimin e Komitetit për Shërbime Publike;
8. Propozim Vendim për Plotësim Ndryshimin e Vendimit të Kuvendit Komunal 01Nr.104/02-18863/19 të datës 28.06.2019 për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim; dhe
9. Raporti i punës së Shtabit komunal për parandalimin e Covid-19 në Komunën e Kaçanikut.

Lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 24 votë Për, Abstenoj Rabiye Sallahi, për shkak se nuk ka qenë pjesë e KK në atë proces. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës e,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 9 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Betimi Solemn i anëtares së zgjedhur të Kuvendit të Komunës nga AAK, Rabiye Sallahi;

Kryesuesi i Kuvendit, E ftoj anëtares e zgjedhur të Kuvendit të Komunës, Rabiye Sallahi të ngritët në këmbë dhe para Kuvendit të Komunës të jep Betimin për Anëtar të Kuvendit të Komunës Kaçanik, ndërkaq në shenjë respekti për anëtarin e zgjedhur të KK, kërkoj të ngritën në këmbë të gjithë të pranishmit që janë në këtë mbledhje.

znj. Rabiye Sallahi- Anëtare e zgjedhur e KK nga AAK, fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit, e lexoj tekstin e Betimin Solemn si në nenin 35.5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si vijon: “Betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”. Deklarata e betimit u nënshkrua nga Rabiye Sallahi.

Kryesuesi i Kuvendit, Falënderoj anëtares e re të Kuvendit të Komunës, Rabiye Sallahi për Betimin e dhënë dhe nënshkrimin e Deklaratës Solemne, i dëshiroj suksese dhe punë të mbarë në aktivitetin e KK, ndërkaq konstatoj;

Ndryshim Plotësimet e përbërjes së Kuvendit të Komunës të Legjislaturës së gjashtë (6) të KK të zgjedhur me 22 Tetor 2017.

Në bazë të Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr. 734-2020 të datës 12.08.2020- pranuar më datë 14.08.2020, anëtarja e dorëhequr nga AAK, Afërdita Shehi(Horuni-mbiemri i bashkëshortit), zëvendësohet me kandidatin e radhës nga subjekti politik i AAK, Rabiye Sallahi. / **Lënda: 01Nr. 60/01-19764/20.**

Anëtarja e Kuvendit të Komunës, Rabiye Sallahi, nga data e dhënies së Betimit dhe nënshkrimit të Deklaratës solemne, i realizon të gjitha të drejtat dhe detyrat si anëtarët tjerë të Kuvendit të Komunës, përfshirë edhe kompensimin (paushallin dhe kompensimin për pjesëmarrje në mbledhje). Anëtarja lartcekur e KK, nga kjo datë i merr të gjitha përgjegjësitë të cilat i takojnë si anëtarët tjerë të KK., ndërkaq anëtarja Afërdita Shehi (Horuni mbiemri i bashkëshortit) pushon të jetë anëtare e KK sipas dispozitave të nenit 37.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040.

2. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të Kuvendit të Komunës u Aprovua pa vërejtje me 3 votë Abstenime (Rabije Sallahi, Ekrem Kyçyku dhe Kaltrina Tafili), sepse të njëjtit nuk ishin pjesë e atij procesi. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

Aprovoj

Procesverbalin nga mbledhja e VI-të (Gjashtë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës 01Nr. 060/01-17631/20 të datës 12 Gusht 2020.

Pyetje dhe Kërkesa

z. Ekrem Kyçyku, Kam një falënderim të veçantë personal për stafin e QKMF,-kryesisht për motrat që punojnë në dhomën e infuzioneve, ndërkaq gjendja çfarë është aty, unë për 7 ditë sa kam marrë infuzion, 6 ditë nuk ka pasur fasha, e mos të flasim për injeksione e barna të tjera.

z. Adnan Reka, Unë kam një kërkesë nga banorët e lagjes 'Ismail Qemali' apo 'Mëhalla Sheh' që të sanohen dëmet nga shiu i para disa ditëve apo të rinovohet rruga në tërësi, dhe të shtrihet ndriçimi publik në gjitha rrugicat e lagjes.

znj. Nazife Krasniqi, Unë kam një Kërkesë për Kryetarin e Komunës; Kërkesa ka të bëjë me Zyrën e pensionistëve e cila zyre nuk po funksionon, ashtu që vetëm një herë në javë po vinte një punëtor. Edhe pse Kryetari i Komunës nuk është kompetent., çështja është më iu bërë trysni në kuptimin që me ardhur të një zgjidhje, sepse është një situatë shumë e rëndë për kategorinë e pensionistëve. Ne, Komiteti për Komunitete që e patëm një mbledhje, e ftuam drejtorin e QPS. Edhe drejtori i kësaj qendre e kishte këtë shqetësim, ndërkaq kërkoj që edhe ne, me ngritur këtë kërkesë, apo kushdo tjetër që ka ndikim qoftë edhe të ndonjë anëtar i Kuvendit të Kosovës, me ngritur këtë çështje në nivel qendror, në mënyrë që me ardhur deri të një zgjidhje.

Kryesuesi i Kuvendit, Pyetje e Kërkesa të tjera nuk ka, besoj së përgjigjet do t'i merrni nga ekzekutivi i komunës, ndërkaq konstatoj me vazhduar me pikët tjera të rendit të punës sipas radhës:

3. Raporti i Auditorit për pasqyrat financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin 2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin, ndërkaq fjalën ua dha anëtarëve sipas paraqitjes;

z. Ekrem Kyçyku, Përshëndetje për të gjithë, Në Raport, Auditori ka dhënë opinion të pamodifikuar me theksim të çështjes. Theksimi i çështjes është së, pagesat e realizuara nga Thesari në emër të komunës në bazë të vendimeve gjyqësore/ përmbarimore, në vlerë prej 153,425€, janë paguar dhe regjistruar në kategoritë joadekuate ekonomike. Auditori edhe kësaj radhe ka gjetur 10 çështje që kanë bëjnë me mangësi e parregullsi. Çështja A1- Keq klasifikim i shpenzimeve. Komuna ka paguar dhe ka regjistruar shpenzime në kategori joadekuate. Çështja A2- Dobësi në dhënie në shfrytëzim të pronës komunale. Komuna nuk ka procedura të parapara me akte nënligjore për dhënie në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës, ndërsa kishte dhënë me qira pronat komunale për periudhën 01.01.2019 deri më 21.12.2019, duke vazhduar kontratat paraprake pa procedura. Kjo është evidentuar në 4 nga 5 mostrat e testuar. Kontratat janë nënshkruar edhe pse qiramarrësit nuk kishin kryer obligimet paraprake. Kjo është në kundërshtim me Ligjin 04/l-044 -Për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim. Çështja B1- Mangësi në evidencat për pronat me

qira. Drejtoria e Urbanizmit, mbanë evidencë për pronat e dhëna me qira, mirëpo ato nuk janë të plota për të siguruar së të gjitha vlerat janë regjistruar saktë, pasi që dallojnë të hyrat e regjistruara në freebalance me ato të evidentuara në regjistrin e brendshëm. Po ashtu nuk kishte kartela financiare për pronat e dhëna me qira. Çështja C1 – Mangësi në angazhimin e stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta. Komuna gjatë vitit 2019 kishte të angazhuar me marrëveshje për shërbime të veçanta 19 punonjës. Edhe pse ishin përdorur procedura të thjeshta rekrutimi, 12 prej tyre ishin nga vitet paraprake, kryesisht nga viti 2014. Këto angazhime ishin për pozita jo specifike të punës, ndërsa duhet të jenë pozita specifike. Çështja A3 – Dobësi në menaxhimin e subvencioneve. Te thirrja për aplikim në “Fushën e Kulturës Rinisë dhe Sportit” nuk ishin kërkuar kriteret e matshme dhe specifike për përzgjedhjen e përfutësve potencial. Në tri raste, zyrtarët nuk arrijnë ta dëshmojnë se si është bërë vlerësimi dhe së nuk janë ofruar procesverbalet nga komisioni për vlerësim siç është e paraparë me rregulloren e brendshme të komunës. Unë e di që edhe anëtarët e komisionit nuk janë ftuar në mbledhje. Çështja A4 – Dobësi në procesin e prokurimit. Gjatë testimit të 5 mostrave të pajtueshmërisë janë vërejtur se në dy raste komuna kishte zhvilluar aktivitete të prokurimit që nuk ishin të përfshira në planin e prokurimit dhe nuk e kishte njoftuar Agjensionin Qendror të Prokurimit. Në tre projekte për punë, komuna nuk kishte hartuar projektin ekzistues, por i kishte zhvilluar procedurat e prokurimit vetëm në bazë të para masës dhe para llogarisë. Çështja B2, ka të bëjë me mangësi në menaxhimin e regjistrave të pasurive dhe shpalosjen e informatave në Pasqyrat financiare vjetore. Çështja B3 ka të bëjë me ka të bëjë me rritjen e vlerës së llogarive të arkëtueshme dhe shpalosje jo e saktë e tyre në PFV. Çështja A5 – Mangësi në prezantimin e obligimeve në PFV. Çështja A6 ka të bëjë me mos kompletimin e Njesisë së Auditorit të Brendshëm. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019, sipas auditorit: 4 rekomandime janë zbatuar, 1 ishte në proces të zbatimit, 3 nuk janë zbatuar ende dhe 3 rekomandime konsiderohen të mbyllura.

z. Adnan Reka, Faleminderit kryesues, Raporti i auditorit edhe këtë vit sikurse vitet e kaluar nxjerr mjaft parregullsi të qeverisjes komunale, duke dhënë një ‘opinion të pamodifikuar me theksim të çështjes’. Auditori së pari ka theksuar çështjen, se: 153,425€ janë paguar për vendime gjyqësore nga kategori jo adekuate buxhetore. Shtrohet pyetja, pse duhet të paguhet nga kategori jo adekuate buxhetore? Ne themi se, komuna jonë duhet të paguaj shumë vendime të tjera gjyqësore nga kategori adekuate buxhetore, prandaj, kjo bëhet për të kamufluar pagesat e shumta të vendimeve gjyqësore që Komuna jonë i rritë për çdo vit. Me pas auditori thotë: Dobësi në dhënien në shfrytëzim të pronës komunale. Komuna jonë jep toka të komunës për shfrytëzim njëvjeçar pa procedura ligjore, madje duke e nënshkruar vazhdimin e kontratave me qiramarrës edhe pa i kryer obligimet financiare, dhe kjo përsëritet përkundër vërejtjeve. Athua, pse bëhet kjo? Sepse Komuna përzgjedh klient politik për t’i shpërblyer për qëllime politike. Mangësi në evidencat për pronat me qira. Auditori thotë, Drejtoria përkatëse nuk mban evidencë për pronat me qira nga neglizhenca e zyrtarëve për mbajtjen e shënimeve. Ne themi, kjo nuk bëhet nga neglizhenca, por bëhet qëllimisht për ta kamufluar inkasimin e të ardhurave nga qiraja. Mangësi në angazhimin e stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta. Në vitin 2019, Komuna jonë kishte 19 punonjës me marrëveshje për shërbime të veçanta, apo kontratë mbi vepër. Kontratat për shërbime të veçanta, ligjërisht nuk mund të zgjaten më tepër se 6 muaj, ndërsa ne i kemi që nga viti 2014, për shërbime jo të veçanta, dhe të pranuar pa konkurs. Dhe, pse ndodh një gjë e tillë? Sepse kjo është mënyra më e mirë për t’i mbajtur peng qytetarët, e më pas për t’i shndërruar në militant partiak. Dobësi në menaxhimin e subvencioneve. Komuna me qëllim nuk paraqet kriteret e mjaftueshme për aplikim në subvencione komunale, që të mund t’i shpërndaj subvencionet sipas preferencave politike, ashtu siç ju pëlqen. Komuna kishte mbështetur filmin ‘Ne kërkim të Venerës’ pa përfillur rregulloret, mbase ka qenë ndonjë intervenim nga lartë. Dobësi në procesin e prokurimit. Komuna ka anashkaluar rregullat dhe proceduar e prokurimit duke i

shpallur tenderët ende pa pasur projekte, vetëm në bazë të paramanës dhe para llogarisë. Mangësi në menaxhimin e regjistrave të pasurive dhe shpalosjen e informatave në PFV. P.sh. Pagesat për shpronësimin e tokës dhe shumë pagesa të tjera nuk janë evidentuar në regjistrat e pasurisë dhe nuk janë shpalosur në PFV duke nënvlerësuar pasuritë kapitale për mbi 400,000€ në total, sepse komuna nuk ka aprovuar rregulloren apo procedurë të brendshme për evidencën, ruajtjen apo tjetërsimin e pasurisë jo financiare ashtu siç kërkohet me ligj. Rritja e vlerës së Llogarive të Arkëtueshme dhe shpalosje jo e saktë në PFV. Mungesa e shënimeve të sakta të LLA, ndikojnë në pasqyrimin jo të vërtetë të këtyre llogarive dhe po ashtu në humbjen e të dhënave dhe humbjen e inkasimit të tyre. Çfarë mund të themi më tepër, paratë mund t'i çojnë ku të duan. Mangësi në prezantimin e obligimeve në PFV. Auditori thotë: Mangësia e shpalosjes së obligimeve të sakta në PFV ndikon në zbatimin e projekteve kapitale për vitin 2020. Ne themi, prandaj mbetemi Komuna më e pa zhvilluar në Kosovë. Detyrimet Kontraktuale, Komuna nuk na ka ofruar informata në vlerën e detyrimeve kontraktuale deri më 31.12.2019. Ne themi, ku me ditë çfarë kontrata ka lidhë komuna, derisa i fsheh informatat. Auditori i Jashtëm thotë 'Rekomandimet e Auditorit të Brendshëm nuk zbatohen, këtë vit zbatimi i rekomandimeve ishte edhe më i ulët se vitin e kaluar, nga 23 rekomandime vetëm 7 janë zbatuar. Fatkeqësisht, ky është raporti i auditorit për vitin 2019, do të thotë para COVID-it, është interesant të shohim vitin e ardhshëm kur do ta kemi edhe COVID-in si shkaktarë.

z. Selim Reka, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, një përshëndetje e veçantë shkon për anëtarin e re të zgjedhur të KK, znj. Rabiye Sallahu, të cilës i dëshirojmë shëndet dhe suksese. Çështja e Auditimit është fokusuar në tri grupe; pasqyrat vjetore financiare, menaxhimi financiar dhe zbatimi i rekomandimeve. Këtu kemi disa theksime të çështjes, si të pagesat e realizuara bazuar në vendime gjyqësore, marrë nga thesari, ku janë regjistruar nga kategori jo adekuate ekonomike. Çështje tjetër është, dhënia në shfrytëzim afatshkurtër në këmbim të pronës së paluajtshme si dhe duke vazhduar kontrata paraprake pa procedura dhe atëherë kur qiramarrësi nuk i kishte krye obligimet paraprake. Me këtë rast është dëmtuar parimi i konkurrencës së lirë dhe trajtimet të barabartë të interesuarve. Mangësi ka edhe në evidencat për pronat me qira, mangësi në barazimet mujore në evidenca, mangësi në angazhimin e stafit me marrëveshje të veçanta, dobësi në menaxhimin e subvencioneve, dobësi në procesin e prokurimit si dhe shpalosje jo të saktë të pasqyrave vjetore financiare të llogarive të arkëtueshme. Nuk po dua me i përsëritë gjërat tjera të cilat i thanë parafolësit e mi. Faleminderit.

z. Nexhat Loku, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, Sa i përket Raportit të auditorit për pasqyrat financiare, vet fakti së opinion është i pamodifikuar me theksim të çështjes, tregon së Komuna e Kaçanikut nuk është keq, por është mirë. Prej të gjeturave, theksimi i çështjes është të shuma 135.000€ dhe arsyetimi është së, nuk janë evidentuar në rubrikën adekuate këto mjete, mirëpo ne e dimë se kush ka punë me vendimet e gjykatës, në momentin që ekzekutohet vendimi në favor të palës, përmbaruesi i tërheqë mjetet pa pyetur së në cilin program buxhetor me i marrë, ai i merr mjetet aty ku e sheh se ka mjete buxhetore të lira. E gjetura që u potencua, dobësi në dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, drejtori e arsyetoj mirë së këto prona janë dhënë në shfrytëzim nga viti 1997. Të e gjetura 4, mangësi në angazhimin e stafit me kontrata me marrëveshje të stafit, raporti është për vitin 2019, ndërkaq auditori thirret në vitin 2014 e që bien ndeshë me vetveten. Punëtorët të cilët u potencuan së janë militant të partisë në pushtet, me sa e di unë me kontrata në vepër janë do punëtorë që pastrojnë qytetin. Unë nuk e di së qysh janë me orientime politike këta punëtorë, por kujtoj së nuk bënë me i etiketuar në mënyra të tilla. E fundit, që buxheti me qenë 7 milion euro, duhet me qenë 3 auditorë të brendshëm. MF nuk lejon asnjë punëtor me tepër sesa numri i përcaktuar

i të punësuarve në bazë të numrit të banorëve. Ne e dimë të gjithë që kemi qenë në një trajnim për këtë çështje dhe e dimë shumë mirë së Hani i Elezit nuk ka fare auditor të brendshëm.

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë bëhet fjalë për një dokument shumë të rëndësishëm- për një kontroll financiar që bëhet gjatë tërë vitit nga auditori i jashtëm, mendoj se duhet ta elaborojmë ashtu siç duhet. Kur flasim për Raportin e auditorit, duhet ta dimë cili është dallimi në mes të raportit të modifikuar dhe atij të pamodifikuar. Nëse flasim për raporte të modifikuara, flasim për raporte me të këqija, ndërkaq raportet e pamodifikuara janë pakëz më të mirë, por jo krejt të mira. Në raporte të pamodifikuara me theksim të çështjes, të cilat auditori gjënë gjetjet të kontrolli i tij financiar, në këtë rast janë disa të gjetura, por krahasuar me vitet paraprake, shihet së të gjeturat janë duke rënë në numër më të vogël dhe kjo është pozitive. Me vet faktin se na është mundësuar me garuar në grantin e performancës, flasim për raport pozitiv, sepse komunat që kanë raport të modifikuar, as që kanë të drejtë me garuar në grantin e performancës. Kur t' dëgjojmë diskutimet e opozitë të bënë me kuptuar se çdo gjë është keq, të gjetura ka, por duhet me u përmirësuar. Nga diskutimet e opozitës të bënë me kuptuar se kemi raport të modifikuar, që d.m.th. çdo gjë është keq. Të çështja e pagesave nga kategoria joadekuate ekonomike, është e drejtë e auditorit që e ka cilësuar kështu, por ne duhet shtrojmë pyetje vetës dhe auditorit së nga cila kategori ekonomike është dashur ne me i paguar këto mjete. A kemi pasur ne mundësi, fjala vjen, në vitin 2018 me ndarë kod buxhetor duke aluduar se kemi me humbur kontestin, atëherë a nuk e kishte cilësuar auditori të gjetur. Askush nuk mundet me paragjykuar një vendim se qysh do të merret nga gjykata. Është vendimi i gjykatës në vlerë 500 mijë euro dhe ne patjetër duhet me i prekur të gjitha kategoritë për me paguar atë borgjin. Të kontratat mbi vepër, mendimi është që, qeveria duhet me i ndalë këto kontrata, sepse auditori pastaj është normale me gjetur vërejtje. Edhe të kjo e gjetur, nuk me shqetëson aq shumë, sepse jemi një ndër komunat që kemi më së paku të punësuar me këso lloj kontratash. Nuk përjashtoj çështje që mund të punësohet militant të partisë në pushtet që e potencoj Adnani, por shumica e të punësuarve janë pastrues të qytetit. Të gjeturat në raport duhet eliminuar. Duhet të fokusohemi të çështjet të cilat mundemi më i përmirësuar. Kushdo që vjen në pushtet, në çdo kohë auditori patjetër ka më dhënë vlerësim për vendimet e gjyqeve, sepse nuk ke ku i merr mjetet, sepse vendimet e gjykatave janë të paparashikueshme. Vendimin që na ka dënuar gjykata është për veprime të mëhershme dhe pa fajin tonë.

z. Ekrem Kyçyku, Replikë; Shënimet janë marrë nga Raporti i auditorit, ju kryesues dhe Nexhat Loku po koncentrohemi vetëm në dy çështje, ndërkaq auditori është përqendruar në 10 çështje. Me vet faktin që Kryetari i Komunës ka pranuar këto të gjetura si në raportin e auditorit dhe ka marrë zotim për zbatimin e tyre, ne nuk kemi çka me thënë tjetër.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Përshëndetje për të gjithë, Fillimisht i uroj marrjen e detyrën anëtares së re të KK, Rabije Sallahi. Po mundohem në pika të shkurtër me dhënë sqarime, pasi që i tha edhe kryesuesi, pozita dhe opozita. Është e drejtë e secilit me na kritikuar, ndërkaq pozita me i mbrojtur qëndrimet e veta. Duhet sqaruar së është viti i tretë që çdo e gjetur e auditorit është element i hetimeve së cilat janë të gjeturat. Kjo nuk përfundon me mendimin e auditorit, por vazhdon, kjo na ka bërë që të jemi të kujdesshëm. Nuk është opinionimi më i mirë që duhet me qenë, por është opinion i mirë, sepse na mundëson çdo lloj gare, sepse tre kushtet kryesore për me qenë pjesë e garave është edhe kjo. Opinioni i auditorit "me theksim të çështje" është për shkak të vendimit të gjykatës i cili vendim na ka ardhur njëherë në vitin 2013, vlera ka qenë diku 300mijë euro, që pala e ka kundërshtuar vlerën e saj. Qysh atëherë me i pas ndarë nga 300mijë euro me një kod të veçantë, ne na ishte dashur nja 7vjet me i ndarë ka 300 mijë euro e me na i kthyer ministria për me i lënë për vitin tjetër për me qenë në rregull sivjet. Asnjëherë ne nuk mundemi me gjykuar sesi do të jetë vendimi final i gjykatës, sikurse ka ardhur vjet pas miratimit të buxhetit, edhe sivjet mund të na vjen. Pjesa tjetër, edhe

unë po mundohem me bërë ajo që më e mirë e mundshme. Një e mirë është së, rekomandimet kanë ardhur duke u zvogëluar. Vendimet që po na vijnë e që nuk kanë ndonjë rrezikshmëri, të çështja që e potencoj Adnani, për pranimet me kontrata në vepër nga 2014-2019, kemi bërë pranime me kontrata në vepër, por jo për 6 vjet, por për 6 muaj. Ashtu sa e lejon ligji dhe pas 6 muajve kanë shkuar në shtëpi. Hulumtoni dhe keni më vërtetuar së ata punëtorë janë pastrues të qytetit, që edhe kur e hap konkursin e brendshëm nuk vjen tjetër kush me aplikuar. Të njëjtit punëtorë që kanë aplikuar kanë ardhur me konkurs, ndoshta edhe vitin e ardhshëm nëse na i mundëson ligji, pot besoj se nuk na mundëson ligji. Merrni raportet dhe e shihni se kemi më së paku si komunë punëtorë me kontratë në vepër. A kemi pasur militant të partisë, po këtë nuk mund të mohoj, por pjesa dërmuese janë punëtorë sezonal që janë pranuar.

z. Adnan Reka, Faleminderit, Me pëlqen debati konstruktiv, nuk kemi nevojë me u nervozuar, secili nga i shpalosim debatet e kritikën e veta.. E para nuk pajtohem se kemi tre opinione të auditimit, opinioni i pamodifikuar që është më i mirë, opinioni i modifikuar që është më i keq dhe opinioni i kualifikuar që është ende me i keq. Theksimi i çështjes nuk është i mirë, se mundet me pasur opinion edhe pa theksim të çështjes -opinion i pamodifikuar pa theksim të çështjes. E dyta që nuk pajtohem është, rekomandimet e auditorit kryetar nuk kanë ardhur duke rënë, por duke u rritur. Vitin e kaluar kanë qenë 20 rekomandime, janë zbatuar 8, vitin paraprak, 23, janë zbatuar 7, kjo është trend i rritje. Sa i përket punëtorëve me kontratë në vepër, ligji nuk të lejon me i marrë nga 2014 dhe me ua vazhduar kontratat në vazhdimësi. Mënyra me e mirë me mbajtur peng dike është më ia bërë kontratën për 6 muaj dhe sa herë ia duhet me iu nënshtruar çka t'i thuash më bërë, sepse mban familje. Po të ia bëni kontratën e përhershme punëtorit, ai mund të ketë edhe opinion të vetin ose një pozicion të vetin, por as me ligj nuk lejohet me pastruar qytetin me kontratë për shërbime të veçanta. Kjo nënkupton për specialistë, ata merren me kontrata të rregullta, e jo për pastrues qyteti.

z. Nexhat Loku, Opinioni i pamodifikuar për mua ky opinion i auditorit është krejt në rregull.

z. Adnan Reka, Opinioni i auditorit i pamodifikuar -me theksim të çështjes, nuk është opinion i mirë, sepse mundemi me pasur opinion, pa theksim të çështjes. Rekomandimet e auditorit kanë ardhur, andaj mbetet obligim i ekzekutivit të komunës me i zbatuar.

z. Bahri Selimi- Drejtor i DEFZH, Unë nuk po dua me i përsëritë disa gjëra që i potencuan kryesuesi dhe kryetari që i dhanë shpjegime, për të cilat theksoj edhe z. Ekrem Kyçyku së janë të pranueshme. Edhe për ne këto të gjetura janë shqetësime, por nuk i kemi refuzuar, i kemi pranuar opinionin e auditorit, ndërkaq na mbetet me punuar në këtë drejtim që të gjetura e auditorit me i zbatuar. Secili nga ne po iu themi sinqerisht se të gjeturat mundet me i lexuar në mënyra të ndryshme, por iu siguroj së paraja publike, po shfrytëzohet në mënyrën më të mirë drejtë të mundur. Asnjë e gjetur nuk ka të bëjë me ndonjë rrezik që dyshohet për ndonjë kamuflim apo diç tjetër të parasë publike. Të gjitha të gjeturat janë të disa shkeljeve procedurale që ndodhin në komuna dhe organizatat tjera buxhetore. Të raporti i auditorit, "theksimi i çështjes" është çështja me e theksuara, këtë e kemi përmendur edhe në planin e veprimit. Momentin që lëndët përmbartimore arrijnë, vet MF apo organi që na jep buxhetin i ekzekuton këto mjete. Drejtorit të financave i drejtohet me një email, që brenda 60 min. me iu treguar se nga më i marrë mjetet, ndërkaq nuk bëhet fjalë për mos tërheqjen e tyre. Ata i kanë ligjet e vet, dhe ne e japim një propozim, aty ku kemi mjete të lira, në shumicën e rasteve të shpronësimi i pronës afër 500 mijë euro është e vërtetë së vlera është kapitale, por kur të vjen puna e ekzekutimit, ne nuk kemi munduar me i ndal realizimin e projekteve edhe ato që janë në procedurë, me i tërhequr mjetet. Ka raste kur kanë gjetur mjete të lira të mallrat dhe shërbimet dhe aty i kanë tërhequr mjetet. Jemi para aktit të kryer, nuk është faji i jonë se me qenë e kisha pranuar, nuk është ndonjë gabim në regjistrat e kontabilitetit, por puna është së nuk është në

dorën tonë, vet MF e merr qasjen në vend të zyrtarit kryesor financiar, kryetarit të komunës dhe i tërheq mjetet nga buxheti i komunës. Të shërbimet e veçanta, e gjetura auditori thotë së, keni angazhuar stafin për pozita jo specifike. Edhe në DEFZH kemi angazhuar staf në afatin ligjor për me i shpërndarë faturat e Tatimi në Pronë (TP) në afatin, 1 Janar-31 Mars. Me ligj, me hapur konkurs, kalon afati ligjor për shpërndarje të faturave të TP. Në këtë rast obligohemi edhe pse nuk është punë specifike shpërndarja e faturave, por detyrohemi për me ia kryer shërbimin qytetarit, me i marrë 2 apo 3 punonjës nga jashtë për me kryer punën brenda afatit të përcaktuar ligjore. Se kush pranohet, a është militant apo jo, kushtet i përcakton konkursi. Mund të shikoni në Zyrën e personelit, dhe e vërtetoni se asnjë pranim i këtyre punëtorëve nuk bëhet pa konkurs paraprak. Të shërbimet publike, të parqet, është periudhë e shkurtër kur duhet kositur e pastruar parqet e sheshet publike që qytetari me lëvizur më lirë. Edhe në këtë rast detyrohemi me angazhuar staf për punë të tilla, sepse me procedurë të rregullt kalon afati për kryerjen e aktiviteteve në fjalë. Edhe nëse pranojmë staf të rregullt, a ia vlen për 2 muaj punë me pranuar staf të rregullt me pagë mujore për tërë vitin. Me kontrata në vepër detyrohemi me i kryer aktivitetin tonë dhe me mbrojtur buxhetin. Të stafi, shpërndarja e faturave të TP kjo mund të bëhet edhe me operatorë ekonomik siç e parasheh ligji, mirëpo për momentin posta e Kosovës bënë shpërndarje të tilla dhe kur kemi angazhuar staf përmes postës, një faturë ka kushtuar 0.45 euro x45 mijë fatura. Punën që e kemi kryer me 5 mijë euro përmes postës, tani e kemi kryer me staf të angazhuar me nga 350 euro për një punëtor. Në këtë rast është ruajtur buxheti i komunës, me çka detyrohemi sepse edhe buxhetin e komunës e kemi simbolik.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatoj së, Kuvendi i Komunës u,
Njoftua

Raporti i Auditorit për pasqyrat financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin 2019.
Lënda: 01 Nr.400/01-20342/20.

4. Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare të Auditimit për PFV 2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Është një Plan që e bënë DEFZH për me u përgjigjur në rekomandimet e dhëna si në raportin e auditorit. Drejtori i financave është këtu, Nëse ka kush di'ka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Ne, edhe në vitin e kaluar e kemi pasur një plan për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit për vitin 2018, mirëpo sa e kemi parë rekomandimet nuk janë zbatuar të gjitha. Duke u nisur nga ajo se rekomandimet e auditorit të dhëna në vitin e kaluar për pasqyrat financiare nuk janë zbatuar, në do të jemi kundër aprovimit të këtij plani.

z. Adnan Reka, Plani i Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të Auditorit është dokumenti që më së miri e nxjerr në pah menaxhimin e Komunës tonë, duke pasur parasysh se nga viti 2015 asnjëherë nuk janë zbatuar as gjysma e rekomandimeve të auditorit. P.sh Për vitin 2015, nga 13 rekomandime të Auditorit, vetëm 2 janë zbatuar Për vitin 2016, nga 24 rekomandime të Auditorit, vetëm 9 janë zbatuar Për vitin 2017, nga 13 rekomandime të Auditorit, vetëm 5 janë zbatuar Për vitin 2018, nga 11 rekomandime të Auditorit, vetëm 4 janë zbatuar. Pra, ky është niveli, do të thotë as gjysma e rekomandimeve nuk ka arritur asnjëherë të zbatohet.

z. Selim Reka, Plani për zbatimin e rekomandimeve të dhëna si në raportin e auditimit të jashtëm është i mirë i hartuar, ndërkaq uroj që i njëjti të zbatohet dhe të kemi sa më pak të gjetura në vitin vijues në pasqyrat financiare. Ne LDK do të votojmë Për këtë plan

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare të Auditimit për PFV 2019 e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin 5 anëtarët nga LVV, Abstenoj Ekrem Raka. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Planit të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare të Auditimit për PFV 2019 / Lënda: 01Nr.400/01-18631/20.

5. Propozim Vendimi për rialokimin dhe transferin e mjeteve nga rezerva komunale sipas buxhetit të vitit 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, materialin e keni marrë, Për sqarime të nevojshme fjalën e ka drejtori i DEFZH, Bahri Selimi.

Drejtori i DEFZH- Bahri Selimi, Këtë Propozim Vendim e kemi sjellë në KK për vet faktin se kemi mjete për herë të parë i kemi pasur 6 kategori të shpenzimeve, është krijuar rezerva si kategori e 6, sepse në vitin e kaluar kur është aprovuar buxheti i vitit 2020, janë planifikuar pagat me rritje siç i ka paraparë ligji për pagat i cili ligj nuk hyri në fuqi për arsye të ndryshme nga niveli qendror. Me këtë rast nga MF ato mjete nuk kemi mundur me i shpenzuar për asnjë qëllim tjetër, kështu kanë figuruar si rezerva. Tani nga MF nga ministrja Hikmete Bajrami e kemi marrë një udhëzim që ato mjete mund t'i përdorim për qëllime të komunave, obligimeve të ndryshme përveç në pagë, si për qëllime të Covid-19, së jemi në gjendje pandemie, për investime kapitale nëse janë marrë mjetet e që ishte rrezikuar ndonjë projekt, mirëpo obligimet komunale që komuna të shkruara dhe të argumentuara janë obligimet që dalin nga kontrata kolektive në sektorin e arsimit. Vlera e këtyre padive është diku 700 mijë euro, mirëpo DAK është kah i rivlerëson edhe një herë, mirëpo prapëseprapë shuma sillet diku 500 mijë euro. Shuma që do të ri destinohet është 538,639 €, por jo e gjithë shuma shkon për paga, për shkak së fondin rezervë që e patëm ndarë për Covid-19, kemi marrë mjete nga disa drejtori, më së shumti është prekur programi, infrastrukturë rrugore, ku kemi pastaj vështirësi me i shlyer obligimet për mirëmbajtje të rrugëve lokale 32.529€ parashihen të rialokohen në mallra e shërbime të DSHPE, shuma 77.715€ është e DSHMS, e cila nuk guxon të ri destinohet në nën programe tjera, po qëndron në të njëjtin nën program të shëndetësisë primare-QKMF. Këto mjete nuk janë lënë në rezervë, për shkak së mjetet në rezervë MF ka të drejtë t'i tërheqë dhe t'i vlerësoj si suficit. Në këtë rast ne kemi paraparë 35 mijë euro më i dërguar në IK, sepse ka nevojë për disa pajisje (aparate), analiza, ndërkaq shuma tjetër 42 mijë euro shkojnë në mallra e shërbime, për shkak se jemi në gjendje pandemia dhe nuk e dimë kur do të përfundoj kjo gjendje. Mjetet në DSHMS mund t'i shfrytëzoj QKMF, edhe pse ka pasur kërkesa të vazhdueshme nga drejtorja, ministrisë për pajisje për Covid-19, me maska, mjete higjienike etj. nuk kemi pranuar ende ndonjë ndihmë, kështu këto mjete nga mallrat dhe shërbimet do të shfrytëzohen për nevoja elementare shëndetësore. Pas aprovimit të këtij vendimi, do të fillojmë me zbatimin e tij, pas procedurave nga MF sepse vonohen në sistem. Po mundohemi t'i kryejmë sivjet, për shkak së vitin vijues mos me i kryer me buxhet të rregullt, kështu tani jemi në situatë të favorshme për ekzekutimin e tyre diku 80 apo 90 % kryhet ky obligim. Është obligim ligjor, kështu që duhet të veprojmë sipas obligimeve që dalin nga MF.

Kryesuesi i Kuvendit, Faleminderit drejtor, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Është bërë pa drejtësi e madhe e kontratës që është lidhur në mes Ministrisë së Arsimit dhe Sindikatës së Arsimit, e cila kontratë me vendimin e gjykatës ka

marrë formën e prerë dhe komuna po obligohet me paguar punëtorëve publik të arsimit, e që kjo është padrejtësi jashtëzakonisht e madhe ndaj punëtorëve tjerë publik. D.m.th. punëtorët e arsimit marrin shujta dhe paga jubilarë. Pagat jubilarë në rregull, por për shujtat, atëherë kjo duhet të bëhet për të gjithë punëtorët publik, në të kundërtën kjo është padrejtësi shumë e madhe.

z. Ekrem Raka, Edhe unë kryesues mendoj së është e padrejtë ndarja e shumës së madhe të mjeteve buxhetore 538 mijë euro që e tha drejtori dhe këto mjete me i marrë vetëm një sektor publik-sektori i Arsimit. Për mendimin tim, kjo ndarje buxhetore është e padrejtë, pavarësisht argumenteve që i theksoj drejtori, të cilat argumente mund të qëndrojnë.

Kryesuesi i Kuvendit, Ne të gjithë po e dimë së qysh është puna, por, na ka ardhur ashtu puna, nënshkruar të kontratës kolektive është Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Arsimit, kështu që ne duhet me zbatuar. Në momentin që është nënshkruar kontrata kolektive është dashur të mbulohet kostoja buxhetore nga qeveria, e jo nga komunat. Ne që jemi më buxhet të vogël na bien barrë edhe më e madhe, kështu që duhet me u përballur edhe më këtë çështje së nuk kemi si me vepruar ndryshe.

z. Selim Reka, Kjo është fat në fatkeqësi, Është mirë janë këto mjete buxhetore, në të kundërtën është dashur të merren nga programet tjera buxhetore. Mjetet janë dhe duhet me i kryer obligimet, sepse nuk kemi rrugë tjetër. Më mirë është më i kryer tani këto obligime, pasi që i kemi mjetet, sesa kur t 'na krijohen edhe obligime të tjera e që mund të vjen puna që nuk kemi nga me i marrë mjetet.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, Propozim Vendimin e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votoj Ekrem Raka, Abstenuan 5 anëtarët nga LVV. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Rialokimin dhe transferin e mjeteve nga rezervat komunale, sipas buxhetit të vitit 2020. / Lënda: 01Nr. 400/01-20296/20.

6. Propozim Vendim për Rialokimin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Theksoj së është fjala për mjetet e mbetura nga një projekt kapital, ridestinohe me qëllim të shpenzimit të tyre. Nëse ka kush diçka në këtë pikë e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë Propozim Vendim e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 5 anëtarët nga LVV. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Rialokimin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2020 në shumë 2,528.50 € të mbetura nga projekti kapital, 'Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve ne f. Gllloboqicë' Rialokohen në projektin, 'Ndërtimi dhe rregullimi i parqeve publike'. / Lënda: 01Nr. 104/02-21420/20.

7. Propozim Vendimi për Plotësim Ndryshimin e Vendimit të Kuvendit Komunal 01Nr.104/02-12813/2018 të datës 27.04.2018 për formimin e Komitetit për Shërbime Publike;

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë Afërdita Shehi ka qenë anëtare në këtë komitet, tani nuk është më anëtare e KK, lind nevoja me ndryshuar dhe plotësuar Vendimin. KSHP përbëhet nga 5

anëtarë nga radhët e anëtarëve të KK, mirëpo më UA të ri dhe LVL parashihet që KSHP duhet të ketë më shumë anëtarë nga OJQ. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, A ka mundësi me ditur, sa anëtar i ka KSHP, sa janë anëtarë të KK dhe sa anëtarë janë të jashtëm ?

Kryesuesi i Kuvendit, KSHP i ka 5 anëtarë nga KK. Komunitet tjerë kanë KSHP me shumë anëtarë. Rekomandimet të cilat po na vijnë, po kërkohet që të inkuadrohet me tepër OJQ në komitete për shkak të transparencës etj. Ne jemi ata që vendosim këtu për përbërjen dhe përfaqësimin. Sot nuk kemi ndonjë emër nga OJQ. Nëse vendosim me qenë KSHP vetëm me anëtarë të KK, mund të vendosim sot këtu, ndërkaq në të kundërtën mbetet për mbledhjen vijuese të KK.

z. Ekrem Raka, Faleminderit Kryesues, Me intereson të di, cila dispozitë që e rregullon këtë çështje e Komitetit për Shërbime Publike është ligjore, jo që e kemi miratuar me e herët, apo tani që po thuhet që ky komitet të ketë anëtarë edhe jashtë KK ? Unë mendoj së përfaqësimi në Komitetin për Shërbime Publike (KSHP) me anëtarë të jashtëm (OJQ/shoqëria civile), e eliminon reflektimin e përfaqësuesve të kuvendit në këtë komitet.

2. KSHP përbëhet nga anëtarë të KK dhe anëtarë jashtë kuvendit. Kjo po i bien që, me na u tek neve, në këtë komitet e emërojmë vetëm një anëtar nga KK. Çështja e përbërjes së KSHP me anëtarë nga KK dhe anëtarë jashtë KK, kjo duhet të specifikohet sesa anëtarë duhet të jenë nga KK dhe sa do të jenë nga OJQ.

z. Nexhat Loku, Ne PDK jemi me shtyrë këtë Propozim Vendim, pasi që nuk e kemi emrin nga OJQ.

z. Ekrem Kyçyku, Edhe ne LVV jemi për me shtyrë për mbledhjen vijuese këtë Propozim Vendim.

z. Adnan Reka, KSHP nuk është as komitet konsultativ e as ekzekutiv.

Kryesuesi i Kuvendit, A jeni me shtyrë për mbledhjen vijuese këtë Propozim Vendim ? Kuvendi i Komunës u pajtua njëzëri më shtyrë për mbledhjen vijuese këtë pikë. Në sajë të kësaj del konkludimi së KK vendosi të shtyjë për mbledhjen vijuese këtë pikë. Nga kjo del konstatimi së Kuvendi i Komunës vendosi që, **Propozim Vendimi për Plotësim Ndryshimin e Vendimit të Kuvendit Komunal 01Nr.104/02-12813/2018 të datës 27.04.2018 për formimin e Komitetit për Shërbime Publike; të SHTYJË për mbledhjen vijuese të KK/ Lënda: 01Nr. 104/02-20873/20.**

8. Propozim Vendim për Plotësim Ndryshimin e Vendimit të Kuvendit Komunal 01Nr.104/02-18863/19 të datës 28.06.2019 për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim;

Kryesuesi i Kuvendit, Në këtë komision ishte anëtar Shpend Krusha nga LVV, andaj Shpendi nuk është më as anëtar i KK, kështu që i kanë pushuar të gjitha pozitat në komisione ku ka qenë anëtar. Kërkojmë nga LVV të jap një emër.

z. Ekrem Kyçyku, Nga LVV për anëtarë të këtij komisioni e propozojmë, z.Agim Mani.

Kryesuesi i Kuvendit, Propozimin e z. Ekrem Kyçyku shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së, Kuvendi i Komunës mori këtë,

VENDIM

Për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të KK 01Nr. 01NR.18863/19 të datës 28.06.2019 për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim, ashtu që ish anëtari i KK nga LVV, Shpend Krusha, i emëruar në këtë komision, zëvendësohet me anëtarin, Agim Mani nga LVV / Lënda: 01Nr. 104/02-20723/20.

9. Raporti i punës së Shtabit komunal për parandalimin e Covid-19 në Komunën e Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit, Për këtë çështje kemi pasur edhe me herët një raport, ky është raporti i dytë, materialin e keni marrë, kryetari është këtu prezent, nëse ka kush diçka lë të urdhëroj;

z. Ekrem Kyçyku, Pasi jam ballafaquar me këtë çështje dhe e kam parë situatën për së afërmi, edhe me herët thash për 7 ditë sa kam marrë infuzion, 6 ditë nuk ka pasur fasha e mos të flasim për injeksione e pajisje mjekësore të tjera. Për një të sëmurë nga Covid-19, shpenzimet janë diku 500-700 euro, ndërkaq mos me pasur edhe fasha, unë kam pasur dhe ua jepja edhe atyre që nuk kishin. Gjendja është alarmante në komunën tonë. Unë i di së paku 50 veta që janë me Covid-19 në komunën tonë e që nuk janë të lajmëruar fare. A ka mundësi prej QKMF me marrë shënime, Sa pacientë kanë marrë terapi kundër Covid-19, me ditur numrin e saktë. Tjetër, është dashur të bëhet më shpesh dezinfektimi i objekteve publike dhe rrugëve, ndërkaq në shtyllat e ndriçimit me vendosur dezinfektues të duarve, ashtu si kanë vepruar disa komuna tjera. Parandalimi është shumë më rëndësi. Kjo sëmundje nuk është hajgare, në fillim edhe unë nuk e kam marrë shumë serioz këtë çështje. Shpresoj që secili nga ju, dhe çdo kush tjetër mos të atakohet me sëmundjen Covid-19.

znj. Kaltrina Tafili, Atëherë, edhe unë iu përshëndes të gjithëve, dhe shpresoj që askush mos me u ballafaquar me virusin Covid-19, edhe pse po e shoh që shumica nga ju jeni pa maska, dhe iu kisha lutur t'i vendosni maskat, sepse kjo sëmundje nuk është hajgare, këtë e di ngaqë unë jam ballafaquar me të. Një kërkesë tjetër është, DSHMS, sa i përket numrit të infektuarve, sepse kjo shifër si në raport nuk është e saktë. As unë nuk kam arritur me u testuar, kam kërkuar ndihmë edhe prej drejtoreshës, por nuk kam arritur me u testuar. Kisha kërkuar që secili që mendon së është i infektuar me Covid-19, të testohet, sepse ka shumë qytetarë që janë duke u ballafaquar me këtë virus dhe nuk mund të dinë as vetë që janë me virus dhe në këtë mënyrë është duke u shpërndarë sëmundja e virusit Covid-19. Kërkoj nga organet e komunës që të bëjnë një kërkesë organeve relevante që të bëhet testimi i sa më shumë qytetarëve të komunës.

z. Besim Vishi, Në raportin e mëhershëm që e kemi shqyrtuar, ka qenë i bashkangjitur edhe raporti financiar, ndërkaq në këtë raport nuk është i bashkangjitur pjesa financiare. Në raport përmendet shuma 25.000€ të shpenzuara, mirëpo ky raport nuk është i pajisur me raport financiar për shpenzimin e këtyre mjeteve.

Kryesuesi i Kuvendit, Kjo është bërë si informatë, ndërkaq raportit të përgjithshëm duhet me ia bashkangjitur edhe raportin financiar të detajuar.

z. Agim Mani, Faleminderit, përshëndetje, Edhe unë jam anëtar i shtabit për parandalimin e Covidit-19. Shprehi kënaqësinë që pata mundësi të kontribuoj sadopak të qytetarët tanë për me kaluar këtë sfidë. Ne si shtab funksionuam si një trupë e përbashkët dhe u angazhuam në përpikëri në detyrat tona që kishim gjatë kësaj periudhe për menaxhimin e situatës dhe parandalimin e virusit covid-19. Gjatë kësaj periudhe kemi harmonizuar qëndrimet tona dhe kemi dalë me qëndrimet të përbashkëta me rekomandimet të cilat ishin edhe të përcaktuara nga MSH të marra gjatë takimeve të shtabit. Rekomandimet e marra janë respektuar në shumicë

nga qytetarët e komunës. Unë personalisht kisha disa shqetësime për menaxhimin e Covid-2019, të cilat i kam shprehur edhe në takime të shtabit. Personat me Covid-19 pozitiv nuk kanë pasur tretman të duhur, dhe assesi të mjaftueshme. Raporti i punës së shtabit, po me duket së është i mangët, nga ajo që është punuar gjatë kësaj periudhe dhe nuk janë specifikuar në detaje përmbajtjet. P.sh, në fund të raportit, përmendet raporti financiar, që e potencoj Besimi, ndërkaq nuk ka raport financiar të bashkangjitur. Nuk është bashkangjitur në raport dezinfektimi i shërbimeve publike, mungon raporti se sa m2 sipërfaqe e objekteve janë dezinfektuar.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Faleminderit, Uroj të mos kemi më të prekur edhe pse kjo nuk varet nga vullneti ynë, megjithatë iu uroj shërim sa më të shpejtë atyre që e kanë pasur dhe atyre që e kanë infektim me Covid-19. Është e vërtetë që QKMF ballafaqohet me vështirësi, por këto nuk janë në domenin e komunës, por është në domenin të ministrisë. Kërkesa kemi bërë sa herë me kohë, por ndoshta mundësitë kanë qenë të kufizuara për shkak të kërkesave dhe nevojave të mëdha, dhe janë ndarë në formën proporcionale ashtu na kanë thënë neve. Shpresojmë tani e tutje kjo gjendje të përmirësohet duke e ditur se edhe numri i atyre që kanë marrë tretman është më i madh sesa në raport. Nuk e dimë numrin, raportin zyrtar do ta marrim në bazë të një kërkesë që do ta bëjë drejtori sesa kërkesa kanë marrë trajtim me Covid-19. Besoj së në mbledhjen tjetër do të kemi një raport shumë më të kompletuar. Ka mangësi, por pasi keni qenë edhe vet pjesë e shtabit, jemi munduar me i përfshirë në formë gjenerale gjërat. Raporti financiar do të jetë në fund, për shkak së disa mjete ende janë në procedura. Përcaktimi i dezinfektimit është kontraktuar nga kompania, dhe ajo bëhet me cent për m2 që dezinfekton. Me kërkesë të drejtorit të QKMF sa herë ka pasur kërkesë është dezinfektuar objekti, pasi që kompania ka qenë e kontraktuar. Është kontraktuar edhe kompania për dezinfektimin e shkollave deri në fund të vitit, dhe në çdo moment kur e shohim të nevojshme jemi të gatshëm për dezinfektim. Po flas në emër të drejtorit të DAK, për shkolla janë siguruar për çdo shkollë pompa për dezinfektim të shpejtë për 5 min. Një klasë në çdo fundjavë në formë gjenerale dezinfektohet krejt shkolla.

z. Adnan Reka, Kur jemi të shkollat, dhe kur flasim për shkollat, disa komuna kanë filluar me aplikuar një aparat për matjen e oksigjenit nëpër klasa apo shkolla, mjet ky jo i kushtueshëm. Mirë është me aplikuar edhe komuna jonë, sepse ai aparat e përcakton matjen e oksigjenit në klasë dhe kjo është një parandalim për Covid-19.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatoj së, Kuvendi i Komunës u,
Njoftua

Me Raportin e punës së Shtabit komunal për parandalimin e Covid-19 në Komunën e Kaçanikut/ Lënda: 01 Nr.104/02-2041/20.

Për fund Kryesuesi i Kuvendit e bëri një Njoftim për anëtarët e KK, si vijon: MF përmes MAPL na i ka kthyer si të kundërligjshëm vendimin për kompensimin e komisioneve të KK. Për mua ishte i paarsyeshëm dhe i pakuptueshëm përgjigja e organit shqyrtues. Ne po e gjejmë një formë përmes shefave të grupeve apo ndonjë formë tjetër për të kundërshtuar këtë vendim, ju si të shihni të arsyeshme. Nëse nuk marrim ndonjë hap, ne në mbledhjen vijuese të KK duhet të shfuqizojmë vendimin të cilin e kemi marrë. Nëse keni ndonjë propozim, ose kur të trajtojmë si temë e diskutojmë.

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu që konstatoj mbledhjen të përfunduar, ora: 12:30. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 26 anëtarë.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu



REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 2007);

nga Mbledhja e VII –të (Shtatë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2020, mbajtur me 08 Shtator 2020;

1. Kemal Mërseli.....,
2. Hamid Guri.....,
3. Ahmet Luma,
4. Kadri Krivenjeva,.....,
5. Besim Vishi,.....,
6. Sali Malsiu.....,
7. Lirije Shurdhani.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,
9. Lirije Luta.....,
10. Vlora Dalloshi.....,
11. Nexhat Loku,
12. Agim Mani.....,
13. Adnan Reka.....,
14. Ekrem Kyçyku.....,
15. Fatijona Kyçyku.....,
16. Kaltrina Tafili,
17. Selim Reka.....,
18. Besnik Salihu,.....,
19. Nazife Krasniqi.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,
21. Shemsedin Luzha.....,
22. Albana Troni.....,
23. Rabije Sallahi,.....,
24. Hajredin Luta.....,
25. Hafize Sallahi,
26. Bekim Koxha.....,
27. Ekrem Raka,......



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 04.09.2020

Për: Anëtarët e Kuvendit/ z. Adnan Reka,
znj. Nazife Krasniqi,
z. Bekim Koxha
z. Besim Vishi

Lënda: PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe të jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruar para Kuvendit të Komunës, më datë 12.08.2020, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.

z. Adnan Reka

1. Pyetje për DSHPE, Drejtor! A jeni ne dijeni së asnjë ujëmbledhës i reshjeve atmosferike nuk është funksional në rrugën e sapo ndërtuar nga ndërtesa e Postës deri të Ura e Konakut, këtë më së miri e dëshmoj shiu që ra para kësaj jave, për dy ditë me radhë ujërat atmosferik vazhduan të rrjedhin si përrua përmes rrugës dhe si pasojë kemi gërryerje të kubzave dhe deformim të kësaj rruge të sapo rinovuar.

- Ujëmbledhesit e vendosur për ujrat atmosferike nga ndërtesa e Postës deri te Ura e Konakut janë të gjithë funksional. Problemi i rrjedhes së ujit të cilën ju e potenconi ka të bëjë me bllokimin e një segmenti të rrjetit të kanalizimit fekal, përballë Stacionit të Policisë, në të cilin është intervenuar nga KRU "Bifurkacioni" që është përgjegjëse për mirëmbajtjen e rrjeteve të kanalizimit fekal.

Gjithashtu është evidente që gjatë reshjeve të shiut kemi rritje të sasisë së ujit në rrjetet e kanalizimit fekal si rrjedhojë e futjes së ulluqeve të qative të shtëpive në sistem të ujrave fekale gjë që dimenzionimi i gypave nuk e përballon sasinë e madhe të ujit që akumulohet nga qatitë e shtëpive private kur ka reshje të shiut.

2. Për kundër përgjigjeve tuaja me shumë politike sesa përmbajtjesore, rruga nga Shtëpia e Kulturës deri të Xhamia e Dëshmorëve në të dyja anët e lumit është e pa ndriçuar, sigurisht ju po e bëni me qëllim për të kursyer buxhetin, por në anën tjetër ju po e instaloni terrin në Komunën tonë, shumë keq!

- Rrjeti i ndriçimit publik përgjatë lumit Nerodime nuk është i përfshirë në masat e reduktimit të kohës së paraparë për ndriçim, por në pjesën nga Shtëpia e Kulturës deri të Xhamia e Dëshmorëve, në të dyja anët e lumit, shumë shpesh kemi veprime vandaliste, duke i dëmtuar trupat ndriçues. Përmes kompanisë së kontraktuar për mirëmbajtjen e ndriçimit publik, intervenojmë në rregullimin dhe rifunksionalizimin tyre gjë e cila ka kosto të vazhdueshme të mirëmbajtjes së tyre.

znj. Nazife Krasniqi

Kam një kërkesë nga banorët e lagjes "Hasan Prishtina" lidhur me mungesën e ndriçimit publik në atë rrugë. Ndriçimi publik në atë rrugë duhet të realizohet, sepse është nevojë dhe kujtoj së kushton shumë realizimi i këtij projekti. Gjithashtu është e nevojshme në atë rrugë të vendoset një barriërë për ndalimin e shpejtësisë, për shkak se kjo rrugë është shumë e frekuentuar

- Ju informoj se në kuadër të planifikimeve të drejtorisë për zgjërim të rrjetit të ndriçimit publik në zonën urbane, në këtë vit është e planifikuar edhe rruga e lartëcekur dhe implementimi saj do të filloj shumë shpejt.

z.Bekim Koxha, Pyetje për drejtorin e DSHPE, Pse mërgimtarët duhet të paguajnë mbeturinat 20 €, kur dihet se ata nuk qëndrojnë këtu.

- Bazuar në Rregulloren Komunale për Taksa Komunale 01 Nr.02-60/01-4863/20, është përcaktuar tarifa për menaxhimin e mbeturinave dhe atë:

Neni 29 i kësaj rregulloreje e precizon në pikën 1.1.1 ku thuhet "Kategoria e ekonomive familjare jo rezidente paguan ¼ e tarifës vjetore për shërbim të menaxhimit të mbeturinave", tarifë e cila do të implementohet nga muaji shtator i këtij viti.

z.Besim Vishi,

Kam një kërkesë për DSHPE për vendosjen e pengesave në rrugë të shtylla dhe të punësoria në afërsi të shkollës fillore në f. Dubravë.. Pengesat mos të bëhen të plastikës, por të jenë me të buta dhe të papërshtatshme. Të energjia elektrike që u potencua së është e dobët në disa fshatra të lagjes Stagovë, projekti ekziston, por nuk është realizuar.

-Drejtoria e Shërbimeve Publike ka të planifikuara lokacione të ndryshme për vendosjen dhe punimin e barrierave (policëve të shtrirë) sidomos në afërsi të institucioneve publik (shkolla, ambulanca, qerdhe etj.) të cilat do të ekzekutohen përmes kompanisë së kontraktuar për vendosjen dhe mirëmbajtjen e sinjalizimit horizontal dhe vertikal dhe asaj për mirëmbajtjen e rrugëve lokale. Në koordinim me ekspertet e kësaj fushe do të vendosim mbi modelin e këtyre barrierave.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt.



Ramadush Osmani

Drejtor i DSHPE-s